



الشمس
الحمراء

Përfaqësuesit e komunitetit në Albany

ملکی، بابا؛ Meleqit, Baba	سرشناسه:
jersha prej Baba Meleqit	عنوان و نام پدیدآور:
Qum: Al-Mustafa International Translation and Publication Center,	مشخصات نشر:
.1393 =2014	
۱۴۸ص.	مشخصات ظاهری:
مرکز بین المللی ترجمه و نشر المصطفی ﷺ: ۶۴پ/۱۲۵/۱۳۹۳	فروست اصلی:
نمایندگی آلبانی؛ ۱۲	فروست فرعی:
۹۷۸-۹۶۴-۱۹۵-۸۴۸-۲	شابک:
فیبا	وضعیت فهرست نویسی:
آلبانیایی.	یادداشت:
شعر آلبانیایی - - قرن ۲۰م.	موضوع:
G9۶۲۱/م۷و۳ ۱۳۹۳	رده بندی کنگره:
۸۹۱/۹۹۱۱	رده بندی دیویی:
۳۵۵۲۱۹۱	شماره کتابشناسی ملی:

Vjersha prej Baba Meleqit

Baba Meleqit



**Al-mustafa International
Translation and Publication Center**

Titulli: Vjersha prej Baba Meleqit

Autori: Baba Meleqit

Botoi: Al-Mustafa International Publication And Translation Center

Tiranë: 2014

ISBN: 978-964-195-848-2

اشعار از بابا ملكى

ناشر: مركز بين المملی ترجمه و نشر المصطفى ﷺ

تیراژ: ۳۰۰

قیمت: ۸۵۰۰۰ ریال

مؤلف: بابا ملكى

چاپ اول: ۱۳۹۳ ش / ۲۰۱۴ م

چاپ: نارنجستان

© Al-Mustafa International Publication and Translation Center

- IRAN, Qom; Muallim avenue western , (Hujjatia). Tel-Fax: +98 25-37839305 - 9
- IRAN, Qom; Boulevard Muhammad Ameen, Y-track Salariyah. Tel: +98 25-32133106, Fax: +98 25-32133146
- IRAN, Tehran; Inqilab Avenue, midway Wisal Shirazi and Quds, off Osko Street, Block 1003. Tel: +98 21-66978920
- IRAN, Mashad; Imam Reza (a.s) Avenue, Danish Avenue Eastern, midway Danish 15 and 17. Tel: +98 511-8543059

www.pub.miu.ac.ir

miup@pub.miu.ac.ir

We wish to acknowledge the assistance of all for finalization of this book

PARATHËNIE

I ndjeri Baba Meleq Shëmërdhenji qysh në kohrat më kritike i shtyrë prej zjarrit dhe ndjenjave patriotike patën bërë shumë vjersha kombëtare dhe besimtare, por fati ose rasti nuk e lejuan për ti arritur qëllimit tija ta plotësonte dhe kështu ato vjersha kanë mbetur në errësirë.

Për gjithë ata që dinë dhe çmojnë vlerën e Baba Meleqit dhe kuptimin e veprave të tia këto vjersha janë të vlefshme. Dhe unë i prekur në ëmbëlsirën e tyre dhe i shtyrë prej shumë dashamirëve përmblodha sa gjeta dhe po i rradhit në këtë libër me shumë kujdes. Këndonjësve ju lutemi masi nuk mundëm të mblidhnim më shumë po sa gjetëm; të na falin dhe në rast se shihet ndonjë gabim masi i kemi mbledhur më shumë pjesë të përhapura dhe duke mos ditur titullin e librit që patën caktuar i ndyri po i vemi emrin e lart shënuar.

FE E KOMBËSI

1

Kush e mbyti firaunë
Prej prehjes në det e shtunë
Simushkonja nemërunë
Dashuria, Dashuria

2

Në pleqëri Zeqerija
Kërkoi djalë nga Perëndia
Kush ia dha Jahjan atija
Dashuria, Dashuria

3

Merjemes ashtu ia dhanë
Pa burrë ebëri Isanë
Punët e Zotit ashtu janë
Dashuria, Dashuria

4

Muhammedin që e rriti
Me Alinë e daroviti
Po Kur'anë kush ia zbriti
Dashuria, Dashuria

5

Kush dha manushaqe
prillit
E zë të bukur bilbilit
Kush dha erë trëndafil
Dashuria, Dashuria

6

Dashurinë e mëmëdhesë
Që kur lind, gjersa të vdesë
Njeriu të mos e presë
Dashuria, Dashuria

7

Meleq kush s'ka dashurinë
Ku t'a dijë Perëndinë
S'njeh as mëmëdhenë e tijë
Dashuria, Dashuria

LUTJE

1

Lutem Perëndi e vërtetë
Mos më lësh në errësi
Pa më jep fuqi në jetë
Të punoj bukur e mirë

2

Të lutem o Zoti jetës
Më largo nga ligësia
Nëmë udhën e së vërtetës
Mos n'andaj nga errësira

3

Të keqen o Zoti ynë
Sa të mira na ke dhënë
Drita jote më hap synë
Po ndonjë në paça lënë

4

Atë ditën e gjykimit
Ligësitë që të bëra
Kur vë peshën e numërimit
Peshoji mirësitë të tëra

5

Moj zemër mos bëj të meta
Po t'i lutesh me dëshirë
Thirri Zotit të vërtetë
Se Ai të bën mëshirë

6

Lut atë që ka në barkut
Gjithë jetën anë e mbanë
Gjë i vuri peshën qarkut
E i ushqen gjithë ç'janë

7

Zemër mos harro
Perëndinë
Po t'i lutesh natë e ditë
Se Ai të jep mirësinë
E të ndez të madhe dritë

8

Zot sa shpirte që ke qitur
Më të dashur ke njerinë
I dhe mendje të stërvitur
E më tepër fuqinë

9

Ty s'të gjendet anë e fundi
Ti vetëm e ke në dorë
Se pa ty s'ka vend gjëkund
Shtije shi, po dhe dëborë

10

Ti jep dimrin e jep dhenë
Jep verën, lulet buçijnë
Sikur s'janë ato që qenë
Na duket të tjera vijnë

11

Ti je det pa fund, pa anë
Unë nga shiu një pikë
Më të mirat gjithë ç'janë
Përzjemë të mos kem frikë

12

Jam një pikë pranë detit
Më dhe fytyrën e mirë
Për dashuri të Muhammedit
Për mua të bësh mëshirë

13

Unë jam një dobështirë
Robi yt ti më ke bërë
Kam shpresën se më bën mirë
Më fal ligësitë të tërë

14

Sa më dhe fuqi përpiqem
Madhërisë tënde falem
Të thërres e shumë digjem
Nga e drejta të mos ndahem

15

Madhëria Jote shumë
Ku kam fjalë unë i gjori
Po lutjen t'a bëj si lumë
Saqë mendja m'a mori

16

Ti je mbret i gjithësisë
Çmimi s'të vihet kurrë
I dhe udhë drejtësisë
Kush t'a marrë e bën burrë

17

Po Ti vetë i ke bërë
Se pa Ty s'ka vend gjëkundi
Prej një drite që të tërë
Që s'i gjendet anë e fundi

18

Kudo hedh sytë në jetë
Pa ty s'shoh një zë të gjallë
Se i ke pushtuar vetë
Njerëzisë u rri në ballë

19

Zot po të duash Ti vetë
Mua ropnë s'më lë kurrë
Të bëj të liga në jetë
Po më bën të urtë burrë

20

Unë jam në dorën tënde
Po mos më lerë të gjorë
M'i largo të ligat vende
Se vetë më ke në dorë

21

S'ta jep madhëria Jote
Sa faje që të kam bërë
Mos më derdh syve të lpte
Po të m'i falësh që të tërë

22

Zot kam fajet posi lumi
Falmi Zot të keqen unë
Se dhe natën s'më zë gjumi
Për Ty s'është e madhe punë

23

Gjithë më kanë nakarë
Unë Ty të kam shpëtonjës
E mos më lerë të qarë
Ti të më bëhesh mburonjës

24

Unë shpresën s'e pres kurrë
Prej Teje sa të jem gjallë
Sipër të më venë gurë
E të më presin me pallë

25

Po ti zemër pre mërzite
T'a dish që je në fron të
lartë
Të ligat po i pështite
Kullohesh si lëmsh i artë

26

Thirrë, lut zemra ime
Zotit të madh e të vërtetë
Qaj me lot e ngashërime
Se të gëzon Ai vetë

27

Meleq; e ke zënë mirë
Atë derë për të lipur
Po ti lutju me dëshirë
Pa Ai s'të lë të mitur.

ME FRIKË

1

Me frikë po e fillojmë
Madhërinë e Perëndisë
S' dimë se si t'a tregojmë
Zotin e madh të gjithësisë

2

Një është i parë e fundi
Det e tërë i ka brenda
Si gjendet ana kurkundi
I ka mbuluar si tënda

3

Shpesh e njërës me shpirt
gjithë
I ka në barku të rria
Ai jep pemë e drithë
Është i vetëm Perëndia

4

Zoti është i madh shumë
Sa nuk e nxe gjithësia
As ha, as po, as fle gjumë
Ku të jesh të she Perëndia

5

Ati shokë mos i vë re
Ç'ka të sheh syri në jetë
Me një fjalë i ka bërë
Zoti i madh e i vërtetë

6

S'ka tjetër të shkosh më
tënë
E të hiqesh veç më njanë
An e mbanë e ka zënë
Gjë e tija gjithë çjanë

7

Sa që është i madh Zoti
Si merr vesh dot rob i tia
Mi kokë sdi ç'i sjell moti
Veç të lutet në Perëndia

8

Madhërin e Perëndisë
Robi se kupton dot kurrë
Kush largohet ligësisë
Ai numërohet burrë

9

Kushdo që bën mirësinë
Lum ai spëton vet'henë
E ka frikë Perëndinë
Lut gjithnjë Muhamenë

10

Shok e miq kush të trazoj
Në ajet është i mallkuar
Zoti do ta përvëlojë
Valëzim ka për të shkuar

11

Zoti është shumë i madh
Meleq, sta pret mëndja
tynë
Po mos kapërce na gardhi
Shiko hape mirë synë

S'MË SHEH PERËNDIA

1

Puno ç'urdhëroj Perëndia
Të ta bënjë natën ditë
Po punove të këqia
Bie në terët e s'sheh dritë

2

Bën liksh s'më sheh
Perëndia
Thotë ajo mendje shkretë
E gënjen pa udhësia
Na ruaj Zot i vërtetë

3

S'mbajnë fjalë e Peërndisë
Ajet e Kuran harrojnë
Pinë qelqet e rakisë
Vetë vehten e turpërojnë

4

Ç'ka urdhëruar Zoti
Pesë kohë fal mos rrini
Sa ini gjall gjithë moti
Gjën e botës mos përpini

5

Robit i bërë mëshirë
Pesë kohët nat e ditë
Po ti falnjë me dëshirë
Zoti madh i dërgon dritë

6

Këmb e duar sy do larë
Urdhërimi i Perëndisë
Ujë duarsh kush të marrë
Lan pagën e robërisë

7

Ramazanë kusht ta mbajë
Për shpirtin e ka fitime
Ligësitë dot ja falnjë
Ti hiqen ato hidhërimë

8

Me xhebrail dërgoj besën
Qysh urdhëroj as më thua?
Mua në më kini shpresën
Ramazan të falur dua

9

Zoti i madh po i ka bërë
Të falur e ramazanë
Dot i mendoj të tërë
Ata që të mos e mbajnë

10

Njeriu le të fitojë
Në kohën e djalërisë
Udhën e drejtë të mësojë
Pa arrirë pleqërisë

11

Meleq; po erdh pleqëria
Liksh as mirë s'merr dot
pjesë
Të kujtohet djalëria
Që e ke humbur si vesë

THERËS

1

Po i thëres Perëndisë
E i lutem nat e ditë
Kur dha shpirtin gjithësië
Më dha dhe mua një dritë

2

Drit e lart e Madhërisë
Që s'ka të sosurë kurrë
Ma dha si folnjëse sisë
Kur derthnja lotë si gurë

3

Më dha dritën e dëshirës
Që ma kishte shkruar pjesë
Mora udhën e së mirës
E lava shtratin me djersë

4

Ajo fuqi e Perëndisë
S'qesh në jetë më qiti
Dhe fjalët e urtësisë
Si vetëtima më ndriti

5

Me lëvdim Zoti s'mbarohet
Pse të them unë ca fjalë
Njeriut zemra ti qërohet
Na e drejta të mos dalë

6

Të marr udhën e vërtetë
Mos marrë paudhësinë
E ti lutet Zotit vetë
Sa pa rënë në greminë

7

Po të kërkosh mirësinë
Zoti ta dërgon pa frikë
Se nuk i jep pakësinë
Pse nxjerr nga deti një pikë

8

Atë që bën e flet fjalë
Me gjallje dhe sa të vdesë
E ligë po s'mund ti dalë
Ja ka bërë vetë pjesë

9

Meleqi; po qan i gjori

Një pikë ujë si vesë

Po Zoti njeri e nxorri

Atë ka të madhe shpresë